

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6730
E enjte, 13 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Aliu: Mbi 75 për qind e ndërtimeve në Kosovë janë pa leje | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA MBAJTUR NJË FJALIM TË ZJARRTË NË KËSHILLIN E EVROPËS KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT PËR UÇK-në, SHKAKU I TË CILIT U KRIJUA GJYKATA SPECIALE | FAQE 4-5

RAMA I FTON VENDET PERËNDIMORE T'I RRËZOJNË FANTAZITË NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është drejtuar të mërkurën Këshillit të Evropës për ta kërkuar rishikimin e raportit të Dick Martyt dhe për t'i shpallur të pabaza akuzat e tij për trafikim të organeve njerëzore gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë. Gjatë fjalës së tij, Rama i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit duke i analizuar të

gjitha pikat e tij. Ai ka thënë se ky raport është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës. "Ju bëj thirrje t'i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Rama

AKTUALE



STOLTENBERGU: MBROJTJA
AJRORE PËR UKRAINËN,
PËRPARËSI KRYESORE | F. 2

LANSOHET FUSHATA 'HAPPY
ONLINE' PËR SIGURINË E FËMIJËVE
NË INTERNET | F. 7

PSD-JA NIS FUSHATËN
ME PROGRAMIN 'BAZË' | F. 3

EKONOMI



VAZHDON AKSIONI PËR
SEKUESTRIMIN E OBJEKTEVE
NË BREZOVICË | F. 8

PENSIONISTËT DO TË MARRIN
NGA 100 EURO SHITESË | F. 8

SPORT



BALLKANI, I GATSHËM SËRISH
T'I GËZOJË SHOIPTARËT | F. 10

QEVERIA PARALAJMËRON ASHPËRSIM TË NDËSHKIMEVE PËR KRIMET SEKSUALE DHE DHUNËN NË FAMILJE | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mox: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Stoltenbergu: Mbrojtja ajrore për Ukrainën, përparësi kryesore

BRUKSEL, 12 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka deklaruar se fuqitë perëndimore po diskutojnë për mënyrat se si t'i ofrojnë Ukrainës më shumë mbrojtje ajrore në kohën kur Rusia po kryen sulme ajrore "pa dallim".

Për dy ditë me radhë Rusia kreu një valë të sulmeve ajrore ndaj rajoneve të Ukrainës, duke bombarduar disa qytete, përfshirë edhe Kievin. Moska tha se sulmet ishin hakmarrje për shpërthimin gjatë fundjavës së kaluar në urën që lidh Krimenë e

aneksuar dhe Rusinë. "Ne do ta adresojmë çështjen sesi ta rrisim mbështetjen për Ukrainën dhe përparësia kryesore do të jetë më shumë mbrojtje ajrore për Ukrainën", tha Stoltenbergu më 12 tetor në takimin dyditor të ministrave të mbrojtjes së NATO-s që mbahet në Bruksel. Përfaqësuesit e më shumë se 50 shteteve, po ashtu, janë mbledhur në margjinat e takimit të NATO-s në Bruksel, për të diskutuar për rritjen e ndihmës për mbrojtje ajrore për Ukrainën.

Presidenti ukrainas Volodymyr

Zelensky u ka kërkuar liderëve të grupit të shtatë shteteve më të industrializuara (G7) që të ofrojnë më shumë ndihmë të mbrojtjes ajrore në mënyrë që shteti i tij t'i neutralizojë sulmet ajrore ruse. Ai tha se sistemet e mbrojtjes ajrore "janë elementë kyç që të ndalet terrori i Rusisë dhe sulmet raketore".

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, por që nga nisja e një kundërofensive ukrainase në fund të shtatorit, Moska ka humbur disa territore që kishte pushtuar në fillim të luftës së paprovokuar.



Biden: Putini e llogariti keq pushtimin e Ukrainës



WASHINGTON, 12 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se presidenti rus, Vladimir Putin, i ka vlerësuar gabimisht kapacitetet e Rusisë për ta pushtuar Ukrainën. Por, lideri amerikan tha se nuk beson se Moska do të përdorë armë taktike bërthamore kundër fqinjët të saj pavarësisht prej kërcënimeve të maskuara ruse për përdorimin e mundshëm të arsenalit bërthamor.

Bideni i bëri këto deklaratë teksa presidenti Volodymyr Zelensky i bëri thirrje Perëndimit për dërgim të shpejtë sistemeve të mbrojtjes ajrore në Ukrainë në mënyrë që shteti i tij të mbrohet nga sulmet ajrore.

Qytetet ukrainase më 10 dhe 11 tetor ka qenë cak i sulmeve vdekjeprurëse ruse që kanë pasur për shënjestër infrastrukturën civile dhe energjetike të shtetit.

Bideni tha për CNN se përderisa ai beson se Putini beson se po vepron në mënyrë racionale, shënjestrat e tij në Ukrainë "nuk janë racionale". "Nëse e dëgjoni fjalimin që bëri pas vendimit që mori [për pushtimin e Ukrainës], ai foli për të gjithë idenë që - ai duhej të ishte lider i Rusisë që bashkon të gjithë rusishtfolësit", tha Bideni.

Në javët e fundit Rusia aneksoi paligjshëm katër rajone ukrainase, që janë pjesërisht të pushtuara, pasi mbajti

referendume që u cilësuan të rreme. Po ashtu, Rusia ka mobilizuar qindra mijëra rusë dhe ka aluduar se mund të përdorë armë bërthamore, duke ngritur alarmin në Perëndim. Sulmet e fundit ruse më 10 dhe 11 tetor erdhën pasi në fundjavë, Ura e Krimesë u godit nga një shpërthim.

Qëllimet e Putinit dhe gjendja e tij mendore kanë qenë subjekt i debatit, pasi ushtria ruse ka pësuar humbje të mëdha ushtarake në Ukrainë. Por, Bideni tha se Putini është "racional" pavarësisht prej gabimeve që ka bërë. "Mendoj se [Putini] është aktor racional, i cili ka bërë një keqlllogaritje të madhe", ka thënë Bideni.

KE rekomandon statusin e vendit kandidat për Bosnjën

BRUKSEL, 12 TETOR - Komisioni Evropian rekomandoi të mërkurën që Bosnjë-Hercegovinës t'i jepet statusi i vendit kandidat për anëtarësim në BE.

Komisionari për zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, ka thënë se vendimi final për këtë vend pritet të merret në muajin dhjetor. Varhelyi foli në Komitetin për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, ku prezantoi paketën vjetore të zgjerimit të BE-së.

Rekomandimi për Bosnjën u tha se është i kushtëzuar, pasi komisioni pret plotësimin e tetë kushteve specifike që lidhen me miratimin e ligjeve për gjykatat dhe prokurorinë, parandalimin e konfliktit të interesit, lirinë e shprehjes dhe migracionin.

Paraprakisht, Kolegji i Komisionarëve Evropianë miratoi paketën vjetore të zgjerimit ashtu si edhe raportet e

progresit për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë.

Në paketën e zgjerimit, Komisioni Evropian vë fokusin në fushat që lidhen me procesin e integritetit evropian, siç janë: sundimi i ligjit, reformat e administratës dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Vend të veçantë zënë, po ashtu, ndikimet e agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Paketa përmban edhe raportime për implementimin e planit evropian për investime në rajon, pastaj për situatën në sektorin e energjisë, për agjendën e gjelbër evropiane, për planet për prokurim të përbashkët të energjisë dhe për përshtatjen e këtyre vendeve me politikat e BE-së, sidomos në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë.



Aliu: Mbi 75 për qind e ndërtimeve janë pa leje në Kosovë

PRISHTINË, 12 TETOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë se mbi 75 për qind e ndërtimeve në Kosovë janë pa leje. Aliu në një konferencë për medie ka theksuar se vetëm në komunën e Prishtinës janë 46 mijë të tilla. "Në regjistrimet pa leje në vendin tonë figurojnë rreth 382 836 ndërtime në të gjithë vendin. Vetëm komuna e Prishtinës i ka mbi 46 mijë ndërtime pa leje. Kjo

nënkupton që nga stoku i ndërtimeve janë mbi 3/4 janë pa leje. Është një numër jashtëzakonisht i madh që ka ndikuar në planifikimet në vend", theksoi Aliu.

Sipas tij, zhvillimi i hovshëm i pasluftës ka bërë që institucionet të mos kenë kapacitete të mjaftueshme për menaxhimin e tyre. "Pavarësisht që në të gjitha vendet e rajonit ka ndërtime pa leje, Kosova si një vend që ka kaluar tranzicionin post-socialist dhe

fazën e luftës, ka një dallim substancial nga vendet e tjera, pasi që për një kohë të gjatë ka pasur një zbrazëturë institucionale dhe nga vitet e pasluftës, nga zhvillimi i madh i hovshëm, institucionet e vendit nuk kanë pasur kapacitete të mjaftueshme ta përcjellin këtë zhvillim e, për pasojë, sot kemi mbi 75 për qind të ndërtimeve ekzistuese pa leje", ka thënë Liburn Aliu, ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.



PSD-ja nis fushatën me programin 'Bazë'

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 TETOR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka nisur fushatën e cilës ia ka vendosur emrin 'Bazë'.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se vendi ka nevojë për ndërhyrje radikale në të gjitha segmentet e shoqërisë për t'i luftuar pabarazinë, varfërinë në të gjitha format e saj si dhe për t'i ofruar qasje të mirëfilltë secilit qytetar të Kosovës në shëndetësi dhe arsim cilësor e gjithëpërfshirës. Ai ka thënë se Kosova, për shumicën e

qytetarëve të saj që kanë pak, është bërë vend jashtëzakonisht i vështirë për të jetuar. "Shëndetësia publike është gërryer prej së brendshmi nga privatizimi i saj. Arsimi, prej atij të hershëm e deri tek ai universitar, është neglizhuar plotësisht nga çdo qeveri që s'e kishte atë në listën e tyre të prioritetëve. Në të njëjtën kohë, punëtorët e Kosovës janë të dorëzuar tërësisht në duart e pamëshirshme të tregut të punës; ata s'kanë siguri në vendin e punës e as mbështetje nga qeveria. E familjet me asistencë sociale detyrimisht

marrin pjesë në ciklin vicioz të varfërisë deri në pafundësi në mënyrë që të ndihmohen nga institucionet e shtetit", ka thënë Molliqaj.

Ai ka shtuar se ky lloj organizimi duhet të përmbysset. "Baza është mënyra e rruga përpara. Ne besojmë se për çdo qytetar të Republikës së Kosovës duhet të ekzistojë një kufi, një bazament, nën të cilin nuk duhet të bjerë, pavarësisht prej krizave ekonomike dhe vështirësive; çdo qytetar i Kosovës duhet ta gëzojë të drejtën që të jetojë dinjitetshëm larg kufirit të varfërisë me një pagë bazike universale; ta gëzojë të

drejtën që në rast të humbjes së vendit të punës, shtatzënisë e lindjes së fëmijës, në rast të sëmundjeve të papritura e shtetit e shoqërisë; të gëzojë të drejtën, qysh në vegjëli, që të ketë qasje në arsim të hershëm e shëndetësi cilësorë publike e universale", është shprehur Molliqaj.

Ai ka thënë se qytetarëve të Kosovës, të cilët mbushin mbi 60 për qind të buxhetit të Kosovës, duhet t'u shpërndahet në mënyrë më të barabartë dhe të drejtë vlera të cilën e krijojnë me punën e tyre. "Kjo gjë do të bëhet me tatime të

reja, si ajo në dividendë dhe trashëgimi, si dhe reformim të tatimeve ekzistuese, si ajo në të ardhurat korporale e të ardhurat personale. Qytetari i Republikës së Kosovës nuk duhet të trajtohet më si subjekt juridik që regjistrohet në librin e amzës e as si numër statistikor në tabela Excel-i. Qytetari i Republikës së Kosovës duhet të trajtohet dinjitetshëm në të gjitha rrethanat shtresëzuese të tij, qoftë ajo duke ia lehtësuar stresin financiar e psikologjik apo trajtimin më të barabartë në vendin e punës. Qytetarit të Kosovës i nevojitet një bazë", ka thënë Molliqaj.

Nga janari deri në shtator, 1 734 mamografi të kryera

PRISHTINË, 12 TETOR - Nga muaji janar deri në muajin shtator në Qendrën Klinike Universitare të

Kosovës, përkatësisht në Klinikën e Radiologjisë, janë kryer 1 734 mamografi. Me rekomandim të

mjekëve specialistë, gjatë kësaj kohe janë bërë edhe 1 350 ultrazë gjiri për pacientët. Sipas raportit të

punës për periudhën nëntëmuajore të këtij viti, janë kryer 321 biopsi të gjirit.





KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA MBAJTUR NJË FJALIM TË ZJARRTË NË KËSHILLIN E EVROPËS KUNDËR RAPORTIT TË DICK MARTYT PËR UÇK-NË, SHKAKU I TË CILIT U KRIJUA GJYKATA SPECIALE

Rama i fton vendet perëndimore t'i rrëzojnë fantazitë ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është drejtuar të mërkurën Këshillit të Evropës për ta kërkuar rishikimin e raportit të Dick Martyt dhe për t'i shpallur të pabaza akuzat e tij për trafikim të organeve njerëzore gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë. Gjatë fjalës së tij, Rama i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit duke i analizuar të gjitha pikat e tij. Ai ka thënë se ky raport është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës. "Ju bëj thirrje t'i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Rama

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

STRASBURG, 12 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë fjalës së tij në Këshillin e Evropës, ka folur të mërkurën për raportin e Dick Martyt dhe Gjykatën Speciale. Teksa ka folur për dëshirën e madhe të Shqipërisë për ta vazhduar rrugëtimin evropian, Rama ka kërkuar nga pjesëmarrësit në asamble që Kosova të thërritet nga ata me emrin e saj të vërtetë, Republika e Kosovës dhe jo Kosovo, gjë të cilën ai e ka cilësuar si një 'mrekulli' nëse do të ndodhte.

Kryeministri Rama u ka bërë thirrje vendeve që nuk njohin Kosovën, ta njohin atë, pasi Kosova është një shtet sovran dhe i lirë. "Ka ardhur momenti

që ndërkombëtarët ta njohin si Kosova dhe jo Kosovo", ka theksuar ai. Rama ka theksuar se ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare njohu luftën e UÇK-së. "Ndërhyrja e ndërkombëtarëve njohu luftën e UÇK-së që solli pavarësinë e vendit. Më pak se një dekadë, në vitin 2008, Carla Del Ponte botoi një libër kujtimesh. Aty Del Ponte pretendonte se krime të tmerrshme ishin kryer nga drejtuesit e UÇK-së. Përfshirë mbi të gjitha trafikimin e organeve njerëzore. Libri natyrshëm shkaktoi valë tronditje në mbarë botën dhe zuri faqet e para nga Evropa në Australi. Pavarësisht prej kësaj, akuzat u mohuan kategorikisht në Kosovë. Pyetja më misterioze e të gjithëve ishte se çfarë e ndaloj një prokurorë të

pushtetshme për të hetuar më tej. Hetimet e saj për çështjen, përfshirë edhe Shqipërinë, kishin dalë me rezultate jobindëse. Por si vazhduan të mbesin këto akuza? Pa gjejeni, këto kujtime ishin aq interesante sa tërhoqën vëmendjen e njerëzve të Vladimir Putinit. Kreu i delegacionit rus në Asambleenë Parlamentare të Evropës në vitin 2008 paraqiti një mocion për të gjithë paraardhësit tuaj. Dhe dëgjoni titullin 'Trajtim çnjerëzor i njerëzve dhe trafikim i paligjshëm i organeve'. Ai përfaqësonte partinë e Putinit. Ai u përballë më vonë me sanksione nga ShBA-ja dhe BE-ja. Natyrisht, jo për një vepër të mirë", ka thënë Rama.

Ai e ka vazhduar fjalimin duke theksuar se, ndërkohë që ky njeri

ra, Dick Marty, puna e tij mbeti dhe vazhdoi përmes Këshillit të Evropës, u ngrit në një nivel më tej. "Pretendime të pavërtetuara të një kryeprokuroreje, në kërkim të shitjes së librit të saj, që çoi në një mocion të paraqitur nga një parti 'Ushtria e bashkuar', që më pas u shndërrua në një rezolutë të kësaj asambleje dhe çoi në krijimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës", është shprehur Rama. Gjatë fjalës së tij, Rama ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit të Martyt duke i analizuar të gjitha pikat e tij. Rama shtoi se raporti është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës.

Më tutje, ai ka thënë se është duke folur për raportin e Dick Martyt dhe akuzat e rrejshme në bazë të të cilave është ngritur edhe Gjykata Speciale, por se ka thënë se këtë nuk po e bën për hir të Kosovës e as Shqipërisë, por për hir të Asamblesë së KE-së, të cilën Rama e ka quajtur "tempull evropian të besimit". "Jam këtu për të kërkuar ta shpëtojme fytyrën tonë, t'i ndihmojmë njerëzit dhe t'u japim shpresë që qëndresa e tyre nuk do të gjykohej. Ju bëj thirrje

t'i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Rama.

Kryeministri shqiptar bëri thirrje tek evropianët që të imagjinojnë një situatë kur presidenti i tyre arrestohet pa asnjë akuzë. "Vetëm për një moment vini në lëvizje. Kur presidenti, apo kryeministri i vendit tuaj merret nga zyra e tij, vihet nën arrest pa asnjë aktakuzë zyrtare. Dikush përmendi Joe Bidenin. Joe Bideni e quante 'George Uashingtoni' i Kosovës. Ai u arrestua nga një autoritet i largët, i panjohur. Pa kuptuar se për çka ishte akuzuar. Thaçi u dorëhoq. U largua me dinjitet, sepse për drejtësinë e kishte vënë jetën në rrezik. Joseph K i gjallë, krijuar nga një lajm i rremë që u përhap si mortajë, e ndikoi edhe politikën ndërkombëtare. S'jam këtu të vë në diskutim Specialen e as procesin gjyqësor. Jam këtu për ta vënë në diskutim burimin e as procesin gjyqësor. Jam këtu për ta vënë në diskutim burimin e infektuar. Kur bota kthehet përmbys, e viktima bëhet kriminel, gjithçka është e mundur. Zhdukjet dallimi mes të vërtetës dhe gënjeshtërs", ka

LB-ja kritikon qeverinë dhe opozitën për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 12 TETOR - Lëvizja për Bashkim (LB), përmes një komunikate për medie, ka reaguar në lidhje me ecurinë e procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Sipas kësaj partie, e cila drejtohet nga Valon Murati, ky dialog nuk ka prodhuar zgjidhje për asnjë prej problemeve kryesore të Kosovës në raport me Serbinë.

Në këtë drejtim LB-ja ka kritikuar edhe kryeministrin aktual, Albin Kurti që, sipas saj, sa ishte në opozitë, ishte një nga kritikuesit më të mëdhenj të këtij dialogu dhe të rezultateve të tij. "Dialogu Kosovë - Serbi, i filluar para më shumë se një dekade, nuk ka prodhuar zgjidhje për asnjë prej problemeve kryesore të Kosovës në raport me Serbinë. Në vend të zgjidhjes së problemit, ai prodhoi vetëm një status quo të brishtë. Kryeministri i sotëm i Kosovës, Albin Kurti, sa ishte në opozitë, ishte një nga kritikuesit më të mëdhenj të këtij dialogu dhe të rezultateve të tij. Ai pati premtuar se sapo të vijë në pushtet do t'i rishqyrtojë të gjitha marrëveshjet, madje edhe duke i dërguar ato në Komisionin e Venecias. Ai,

kryeministri Kurti, jo vetëm që nuk e bëri këtë por, për më keq, e vazhdoi konceptin e njëjtë si qeveritë pararendëse. Duke e trajtuar dialogun si teknik, ai po detyrohet të bëjë marrëveshje të reja në frymën e vjetër, si dhe t'i jetësojë një nga një ato marrëveshje të vjetra, 'tradhtarë', siç i quante ai dikur. Marrëveshje të cilat do ta degradojnë edhe më shumë sovranitetin e brishtë të Kosovës", thuhet në komunikatën e LB-së.

LB-ja ka vlerësuar se edhe opozita e sotme, pushtetarët e djeshëm (PDK, LDK e AAK), kanë qëndrim të njëjtë me Albin Kurtin e qeverinë e tij sa i përket dialogut Kosovë - Serbi. "Dhe kjo është ana më e keqe e krejt kësaj çështjeje", theksohet në komunikatën e LB-së për të vazhduar tutje: "Kohën e fundit edhe nga ndërmjetësuesit e dialogut është duke u shqyrtuar mundësia e ridizajnit të tij, pikërisht për shkak të mungesës së rezultateve dhe të shterpësisë së këtij lloji të dialogut. Sërish edhe pozita, edhe opozita në Kosovë do të gjenden të papërgatitura për këtë ridizajnim, pikërisht për shkak se u mungojnë idetë, e çka është edhe



më keq, u mungon edhe vullneti, sepse si pozita, ashtu edhe opozita, çështjen e dialogut Kosovë - Serbi gjithmonë e kanë parë dhe vazhdojnë ta shohin vetëm si një frikë elektorale dhe si një detyrim ndërkombëtar. Prandaj nuk i qasen me seriozitetin e nevojshëm e të domosdoshëm kësaj çështjeje me rëndësi jetike për Kosovën dhe qytetarët e saj", thuhet në këtë komunikatë.

Sipas LB-së, është dashur ta dimë që në fillim, por duhet ta dimë sidomos tani, se dialogu i cili zhvillohet vetëm për serbët e Kosovës dhe të drejtat (privilegjet) e tyre, do të prodhojë vetëm kompromise e marrëveshje të pakuptimta, që nuk zgjidhin gjë. "Derisa ne e heshtim dhe nuk e shtrojmë drejt për zgjidhje edhe çështjen e Kosovës Lindore (Preshevë, Bujanovc e Medvegje), dialogu vetëm do të na sjellë

vështirësi dhe nuk do të prodhojë asgjë të mirë. Prandaj, ridizajnimi i dialogut Kosovë - Serbi duhet të bëhet mbi bazën e të drejtave të njëjta si për serbët e veriut të Kosovës, ashtu edhe për shqiptarët e Kosovës Lindore, pa e përfshirë edhe ripërcaktimin e kufijve Kosovë - Serbi mbi po këtë parim. Rrugët e tjera na lënë këtu ku jemi - në status quo aspak të favorshme për ne", është thënë në komunikatën e LB-së.



theksuar Rama, duke shtuar se si rrjedhojë e vendimit të kësaj Asambleje, bota e drejtësisë u kthye përmbys. "Viktimat u kthyen në kriminelë. Kërkimi për të vërtetën u kthye në një përsëritje gënjeshtresh. Një njeri luftëtar u shndërrua në një krye të një bande mafioze. Një udhëheqës i zgjedhur që ndërtonte paqen, u shndërrua në

një kriminel. Lufta çlirimtare u kthye në një histori të trafikimit të organeve. Ata që u shpëtuan nga ndërhyrja humanitare, u akuzuan për krime nga më të tmerrshmet. Drejtësia ndërkombëtare u mënjanua nga hipokrizia ndërkombëtare", ka deklaruar Rama

Në rezolutën e miratuar në Kuvendin e Shqipërisë më 21

korrik, kërkohet që akuzat e raportit të Martyt të konsiderohen të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte.

Fjalimin e Ramës në KE e kanë përshëndetur lideri i PDK-së, Memli Krasniqi dhe ish-kryeministri Avdullah Hoti. "Është fat i madh për Kosovën që në këtë periudhë sfiduese,

Shqipëria ka një kryeministër si Edi Rama, i cili nuk e humb asnjë mundësi që i jepet për ta mbrojtur Kosovën, luftën tonë çlirimtare dhe të drejtën tonë të patjetërsueshme për liri dhe pavarësi. Faleminderit kryeministër Rama për qëndrimin dinjitoz dhe dashurinë e pakushtëzuar për Kosovën. Populli i Kosovës të është mirënjohës!", ka shkruar Krasniqi

në "Facebook". Edhe Hoti e ka falënderuar Ramën për fjalën në Këshillin e Evropës. "Derisa Kosova të anëtarësohet në mekanizmat ndërkombëtarë, Shqipëria mbetet zëri ynë krahas vendeve mike që kanë mbështetur përpjekjet e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi", ka shkruar ai në "Facebook".

Rama për "Shtëpinë e verdhë": Si mund të kryhej aty trafik organesh, s'kishte drita, ujë e as rrugë?

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka sjellë në vëmendje historinë e "Shtëpisë së verdhë", ku në raport pretendohet se kryhej trafikimi i organeve. Ai ka thënë se këto janë të pabaza, duke thënë se ajo ishte shtëpia e një familjeje të varfër shqiptare, që nuk kishte drita, ujë e as rrugë. "Është një prej të shumtave në këto zona të thella, vetë fshati që ndodhet në një zonë shumë të largët në veri të Shqipërisë, që asokohe ishte i izoluar nga rrugët, furnizimi me ujë të pijshëm dhe energjia. Nuk është vendi ideal për ndërhyje të këtij lloji si heqja e organeve. Ju kërkoi ndjesë që po ju ftoj në këtë përfytyrim, të heqësh organe në

një vend pa ujë, pa drita e pa rrugë, e jo më pa pajisje të specializuara. Fshatarët u pyetën dhe u përgjigjën se kurrë nuk kishin dëgjuar të tilla gjëra, por edhe për heshitjen e tyre, fantazitë që u paraqitën këtu, morën një përgjigje 'shkruhet se u referohen kërcënimeve'. Raporti mbështetet në stereotipa të dëmshme, ngatërrimi i një fshati tradicional me një rrugë dritash të kuqe të një kryeqyteti evropian perëndimor, do të bënte për të qeshur. Kjo nuk është për të qeshur që këta të rinj etiketohen si anëtarë të një grupi të rrezikshëm që trafikojnë organe. Shqiptarët etiketohen si inferiorë", ka thënë Rama.

Hyseni: Faza e parë e punimeve në palestrën sportive në Zhegër pritet të finalizohet së shpejti

GJILAN, 12 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku,

kanë vizituar punimet në palestrën e fshatit Zhegër, për t'u siguruar që po punohet sipas planit.

Kryetari Hyseni ka thënë se

faza e parë e këtij projekti pritet të finalizohet së shpejti. "Gjilani frymon me sportin, e sportdashësit e Gjilanit meritojnë më shumë objekte e

hapësira sportive, për të cilat po punojmë çdo ditë që t'i shtojmë", ka thënë kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni.



Kryetari i Prishtinës diskuton me anëtarët e Odës Amerikane lidhur me zhvillimin e qytetit

PRISHTINË, 12 TETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, është takuar të mërkurën me anëtarët e Odës Ekonomike Amerikane për të diskutuar lidhur me projektet zhvillimore për qytetin e Prishtinës, përfshirë edhe zhvillimin e zonave ekonomike, të cilat do ta lehtësonin edhe të bërit biznes brenda Prishtinës.

Rama ka folur për planet e komunës së Prishtinës për përmirësimin e mobilitetit brenda qytetit, por edhe mundësitë e realizimit të projekteve specifike përmes partneritetit publiko-privat.

Gjithashtu, ai ka folur edhe për

rëndësinë e Arkitektit të Qytetit, iniciativë kjo e autoriteteve komunale, duke theksuar se, përveç planifikimit të mirëfilltë urban, Arkitekti i Qytetit do të ndihmojë edhe në reduktimin e burokracisë, ofrimin e transparencës më të madhe dhe, rrjedhimisht, eliminimin e korrupsionit.

Koncepti i qyteteve inteligjente dhe përdorimi i zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit për ta avancuar menaxhimin e qytetit ishte, po ashtu, në fokus të diskutimit ndërmjet kryetarit Rama dhe përfaqësuesve të sektorit privat.



Filloi puna për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës së Malishevës



MALISHEVË, 12 TETOR - Pas vendimit të kuvendit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës së Malishevës, të mërkurën është mbajtur mbledhja e parë e komisionit të formuar për hartimin e draftit të statutit të ri. Mbledhja është drejtuar nga

kryesuesi i KK të Malishevës, Argjend Thaçi.

Në këtë mbledhje nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi, anëtar i komisionit, në fjalën e tij, ndër të tjera, tha se komuna e Malishevës punon ende me statutin e vitit 2008. "Prandaj zhvillimet si në ligje dhe

në akte normative të tjera kanë ndryshuar, ashtu edhe zbatimi ende i këtij statutit po na paraqet vështirësi për nxjerrjen e shumë vendimeve dhe kryerjen e punëve, kështu që nisma për ndryshimin dhe plotësimin e aktit më të lartë të komunës së Malishevës do ta ndihmonte

shumë jo vetëm ekzekutivin, kuvendin, por edhe drejtoritë e sektorët e tjerë si dhe vetë qytetarët e grupet e interesit në komunën e Malishevës", ka thënë Krasniqi, duke kërkuar bashkërendim të punëve në vazhdim mes anëtarëve të komisionit.

Në këtë komision janë të përfshirë të gjitha subjektet politike që janë pjesë e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ekzekutivi dhe shoqëria civile. Ky komision do ta vazhdojë punën e tij, deri në hartimin e draftit të statutit dhe me të vazhdohet me konsultime-debate publike deri

Funksionalizohet Ambulanca e Mjekësisë Familjare në Bajgorë

MITROVICË, 12 TETOR - Drejtorja për Shëndetësi në Mitrovicë, pas një kohe të gjatë, ka arritur ta funksionalizojë Ambulancën e Mjekësisë Familjare në fshatin Bajgorë, e cila tashmë ka rifilluar punën.

Kjo ambulancë ofron shërbime mjekësore nga ekipet mjekësore të cilët janë të angazhuara të punojnë

rregullisht dy ditë në javë të martën dhe të premten.

Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Fahri Shabani, ka bërë me dije se përveç funksionalizimit të kësaj ambulance, do ta vazhdojnë funksionalizimin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Selac, ndërsa pas renovimit të objekteve së shpejti edhe në Vllahi,

Zabërgj dhe Rashan.

Po ashtu, ai ka potencuar se AMF-ja në Bajgorë, përpos rifillimit të punës, Drejtorja për Shëndetësi në planifikimet e saj për investime në shëndetësi ka paraparë edhe renovimin e tërësishëm të këtij objekti, në kuadër të transformimit pozitiv të shëndetësisë primare të Mitrovicës.



Qeveria paralajmëron ashpërsimin e ndëshkimeve për krimet seksuale dhe dhunën në familje

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 12 tetor - Qeveria e Kosovës ka miratuar një projektligj për ndryshimin e Kodit Penal, që ashpëron dënimet për veprat penale të dhunimit, sulmit seksual dhe dhunës në familje.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se këto ndryshime janë të nevojshme dhe urgjente për shkak të rritjes së rasteve të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale.

Haxhiu tha se Këshilli Gjyqësor do të ketë regjistër me informacionet e personave që shpallen fajtorë për veprat e tilla penale dhe ky regjistër do të jetë publik. Njëkohësisht, ajo tha se gjykatat do të obligohen që t'i publikojnë aktgjykimet për këto raste.

Sipas ministres Haxhiu, ndryshimet parashohin që personave që shpallen fajtorë për dhunim dhe dhunë në familje t'u ndalohet e drejta e kandidimit në pozita publike nga 3 deri në 10 vjet. Po ashtu, sipas ndryshimeve, atyre do t'u ndalohet punësimi në sektorin publik dhe do t'u hiqet e drejta e marrjes së patentë-shoferit dhe e drejta e ngasjes së veturës për 1 deri në 5 vjet.

Të dënuarit për veprat penale të dhunimit dhe dhunës në familje, po ashtu, nuk do të kenë të drejtë të blejnë asete publike në ankande nga 3 deri në 10 vjet dhe për periudhë të njëjtë do t'u ndalohet edhe aplikimi si investitorë

strategjikë. "Po ashtu, është paraparë që kur kemi të bëjmë me veprën penale të dhunimit, sulmit seksual dhe dhunës në familje, kufijtë e zbutjes së dënimeve nuk do të zbatohen. Është paraparë edhe një vepër e re, sipas së cilës, do të ndëshkohet kushdo që me qëllim të frikësimit ose detyrimit për të vepruar kundër vullnetit të tyre, me dashje ushtron dhunë psikike, fizike, seksuale, ekonomike në formë të drejtpërdrejtë apo indirekte ndaj grave që ushtrajnë funksione publike apo kandidatëve për ushtrimin e funksioneve publike", tha Haxhiu.

Ajo tha se për veprën e re penale është paraparë ndëshkim nga 6 muaj deri në 3 vjet, dhe nëse ajo kryhet në formë të organizuar, do të cilësohet si rrethanë rënduese. "Kosova nuk ka jetë grash dhe vajzash për të humbur. Dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është çështje private, është përgjegjësi institucionale, është çështje e sigurisë dhe mirëqenies publike e sociale. Është i domosdoshëm angazhimi maksimal, veçanërisht i institucioneve, por edhe i çdonjërit nga ne, prindërve, familjes, mësimitdhënësve, zyrtarëve të rendit dhe mbrojtjes së ligjit, të të gjithë qytetarëve", tha Haxhiu gjatë konferencës për medie pas mbledhjes së qeverisë.

Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës më 12 tetor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se gjyqtarët dhe prokurorët nuk po



reagojnë si duhet për rastet e dhunimeve dhe dhunës në familje, teksa përmendi edhe rastin e fundit të dhunimit të një 11-vjeçeje në Prishtinë nga pesë persona, duke shtuar se opinioni "u shtang" nga kjo ngjarje. "Përderisa shoqëria reagon me protesta masive dhe kërkon drejtësi për viktimat, sistemi gjyqësor hesht. Ne nuk mund ta bëjmë detyrën e gjyqtarit e as të

prokurorit, por mund të hartojmë politika që shtyjnë gjyqtarët e prokurorët të reagojnë, e të veprojnë më shumë e më shpejt, që sjellin përgjigje ndaj thirrjeve të shoqërisë për të sjellë drejtësi", tha Kurti. Sipas procedurave, ky projektligj për plotësim/ndryshimin e Kodit Penal duhet të dërgohet në komisionet parlamentare, më pas të dërgohet

për miratim në seancë plenare. Nga janari deri në tetor në Policinë e Kosovës janë raportuar 73 raste të ngacmimit seksual dhe 49 raste të sulmit seksual. Sipas organizatave joqeveritare, numri më i madh i viktimave janë vajza të moshës 13 deri në 16 vjeç. Kodi Penal i Kosovës parashihet dënime nga 2 deri në 15 vjet burgim për dhunime dhe sulme të tjera seksuale.

Lansohet fushata 'Happy online' për sigurinë e fëmijëve në internet

PRISHTINË, 12 TETOR - Qeveria e Kosovës dhe partnerët e saj kanë lansuar një fushatë të re të quajtur 'Happy online', për t'i mbajtur fëmijët të sigurt në internet.

Në vitet e fundit Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë shumë ndërhyrje me partnerët e shoqërisë civile për ta përmirësuar edukimin medial dhe sigurinë e fëmijëve në internet. Kjo qasje e re 'Happy online' do të punojë me prindërit për t'u siguruar që ata janë të vetëdijshëm se çfarë mund të bëjnë për t'i mbajtur fëmijët e tyre të sigurt në platformat digjitale.

Sipas një njoftimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prindërit duhet të jenë më të vetëdijshëm për rreziqet e shumta që paraqiten në internet nga dhuna, pornografia, vetëvraska dhe radikalizimi e deri tek ekstremizmi. Kjo fushatë u përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve të tyre se si t'i mbrojnë fëmijët e tyre në internet. "Interneti është një dritare magjike për fëmijët të cilët duan të shkojnë përtej përditshmërisë. Flisni me

fëmijët tuaj, edukoni dhe kujdesuni mbi përmbytjen që fëmijët ndajnë me të tjerët në publik. Mbani ata të sigurt dhe larg bullizmit e ngacmuesve potencialë, ekstremizmit e çfarëdo forme tjetër që rrezikon mirëqenien e sigurinë e fëmijëve tuaj. Kështu, duke marrë një rol aktiv në aktivitetet e fëmijëve tuaj në internet, ju ndihmoni të siguroheni që ata të përfitojnë prej këtyre aktiviteteve dhe që të eksplorojnë një liri të re pa u ekspozuar ndaj rreziqeve të mundshme", ka thënë ministri i MPB-së, Xhelal Sveçla.

Përmes kësaj fushate, Ministria e Punëve të Brendshme do të shtojë një shtresë tjetër mbrojtjeje për të rinjtë kundër përdorimit të internetit për radikalizimin, korrupsionin dhe dëmet e tjera.

Kjo fushatë do t'i informojë dhe mësojë prindërit për atë që duhet të shqetësohen dhe si t'i mbajnë fëmijët e tyre të sigurt, duke zhvilluar biseda, duke ditur për parametrat e sigurisë dhe duke i trajtuar në qasje të drejtë dhe të sigurt.



HAPPY ONLINE
Udhëzuesi i prindërve rreth dëmeve online

Fëmija juaj mund të mos jetë i sigurt online!
Bisedo me të, mbroje atë.

Vazhdon aksioni për sekuestrimin e objekteve në Brezovicë

PRISHTINË, 12 TETOR - Prokuroria e Ferizajt ka njoftuar se edhe të mërkurën ka vazhduar sekuestrimi i objekteve që dyshohet se janë ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme në Brezovicë.

Aksioni për sekuestrimin e rreth 100 objekteve në Brezovicë ka nisur më 11 tetor. Prokurori i rastit të Brezovicës, Rasim Maloku, ka thënë një ditë më parë se objektet e sekuestruara në Brezovicë ishin në pronësi të politikanëve, biznesmenëve dhe qytetarëve të tjerë.

Objektet që po sekuestrohen përkohësisht gjenden në zonën e dytë të Brezovicës, në Parkun Kombëtar "Sharri". Në këtë zonë nuk lejohet ndërtimi. "Raportet e pranuar lidhur me këtë rast nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda në Prishtinë dhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Departamenti për Menaxhim i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit vërtetojnë se në këtë zonë janë të ndërtuara rreth 100 objekte në kundërshtim me Ligjin për Parkun Kombëtar "Sharri" si dhe Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri" të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës", u tha në njoftimin e Prokurorisë së Ferizajt.

Prokurori Maloku bëri me dije se në mesin e objekteve të sekuestruara janë 80 objekte të ndërtuara plotësisht e të tjerat në ndërtim e sipër. Përveç vilave, është sekuestruar edhe një hotel.

Ndërkaq, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Liburn Aliu, gjatë një konference për medie, më 12 tetor tha se



problemet që shfaqen me ndërtimet e kundërligjshme në Brezovicë, është se ka "dualizëm" mes kompetencave të komunave dhe ministrive. "Aksioni në Brezovicë është jashtëzakonisht i qëlluar dhe është duke e pasur efektin e vet. Degradimi që ka ndodhur në zonën e Brezovicës, përgjithësisht në Parkun 'Sharri', janë të natyrave të ndryshme. Përpos ndërtimeve pa leje, janë edhe hidrocentralet dhe prerja e pyjeve që ka qenë një proces i vazhdueshëm dhe degradues në të gjitha parqet nacionale,

edhe në Parkun 'Sharr' dhe të 'Bjeshkëve të Nemuna', tha Aliu.

Duke folur për Brezovicën, ai tha se Ligji për Ndërtim u jep kompetenca komunave sa i përket ndërtimeve të objekteve individuale dhe kolektive, ndërkaq Ligji për Parqet Nacionale u jep kompetencë ministrive. Por, Aliu tha se ministritë zakonisht "nuk kanë kapacitete për procedimin e këtyre rasteve", teksa shtoi se tri e katërta e ndërtimeve në nivel vendi, janë ndërtime pa leje. Rasti gjyqësor "Brezovica" është

inicuar në dhjetor të vitit 2021. Deri më tani janë arrestuar dhjetëra persona, përfshirë edhe ish-kryetari i komunës së Shtërpcës, Bratislav Nikolliq, por edhe zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Nikolliq, që është zyrtar i lartë i partisë kryesore të serbëve në Kosovë, Lista Serbe, dyshohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Prokuroria dyshon se Nikolliq ka lëshuar paligjshëm leje ndërtimi në Brezovicë dhe të përfshirët në këtë rast, përveç keqpërdorimit të

detyrës zyrtare, dyshohen edhe për rryshfet.

Autoritetet gjyqësore kanë njoftuar se hetimet për rastin "Brezovica" do të vazhdojnë edhe gjatë vitit të ardhshëm, pasi pritet të dërgohen edhe lëndë të tjera në gjykatë për disa të dyshuar.

Brezovica cilësohet një prej qendrave më të mëdha të turizmit dimëror në Kosovë dhe njihet për qendrën e saj të skijimit. Ajo gjendet në komunën e Shtërpcës dhe bën pjesë në Parkun Kombëtar "Sharri".

Pensionistët do të marrin nga 100 euro shtesë



PRISHTINË, 12 TETOR - Pensionistët e Kosovës në muajin tetor do të marrin nga 100 euro shtesë, kështu vendosi Qeveria e Kosovës më 12 tetor. Ndarja e këtyre mjeteve është në kuadër të pakos për përballje me inflacionin, tha zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, gjatë mbledhjes së qeverisë. "Prandaj, për këtë qëllim duhet të ndahen mjete buxhetore prej 28 milionë eurosh", tha ai.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2021, Kosova ka rreth 143 mijë pensionistë që marrin pensionet bazike të moshës, nga 100 euro në muaj, dhe rreth 50 mijë pensionistë kontributpagues të moshës. Këta të fundit ndahen në katër kategori dhe marrin nga 182 deri në 265 euro në muaj, varësisht nga niveli i shkollimit që kanë pasur. Në kuadër të pakos për përballje me inflacionin, që

kap shumën 150 milionë euro, muajin e kaluar janë mbështetur me dyfishim të vlerës së asistencës sociale familjet që marrin këtë ndihmë. Po ashtu, nga 50 euro shtesë kanë marrë punëtorët e sektorit publik dhe nga 100 euro kanë marrë punëtorët e ndërmarrjeve publike.

Në mesin e këtij muaji shtesa prej 100 eurosh do të ekzekutohet për pensionistët. Po këtë shumë në muajin nëntor do ta marrin edhe studentët.

Vazhdon shtrenjtimi i naftës në Kosovë

PRISHTINË, 12 TETOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka caktuar çmimet tavan për shitjen e derivateve të naftës për 24

orët e fundit. Sipas vendimit, çmimi maksimal i lejuar i naftës për ditën e mërkurë ishte 1.76 euro për litër, i benzinës me 1.40 euro dhe

i gazit me 0.75 euro, pra ka shtrenjtim prej 4 centësh për naftë, derisa ka mbetur i pandryshuar ai benzinës dhe lirim prej 1 centësh për gazin. Pavarësisht prej

zbritjes së dukshme të çmimit të derivateve të naftës në botë, vlera e naftës në Kosovë në javët e fundit ka shënuar vlera rekorde.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON ENVERI
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ballkani, i gatshëm sërish t'i gëzojë shqiptarët



Kampionët e Kosovës në futboll janë përgatitur maksimalisht t'ua dhurojnë tifozëve shqiptarë edhe një tjetër gëzim nga garat evropiane. Futbollistëve që drejtohen nga Ilir Daja suksese u ka uruar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. "Djelmohat e FC 'Ballkani' nga Suhareka kanë shënuar sukses historik në garat evropiane të Ligës së Konferencës së UEFA-s. Sot pata kënaqësinë t'i pres në zyrën time, t'i përgëzoj për sukseset e deritashme dhe t'u uroj fitore në përballje me ekipin 'Sivasspor'", ka thënë Osmani

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 TETOR - Skuadra e Ballkanit sonte (e enjte) e zhvillon ndeshjen e katërt në Ligën e Konferencës. Kundërshtar e ka Sivassporin nga Turqia. Të përzgjedhurit e trajnerit Ilir Daja shënuan fitore ndaj ekipit turk para një jave dhe të njëjtën gjë po synojnë ta bëjnë edhe në këtë ndeshje dhe t'ua dhurojnë tifozëve shqiptarë edhe një gëzim nga garat evropiane. Me fitore Ballkani do të ishte shumë afër kualifikimit historik në fazën tjetër.

Një ditë para ndeshjes, në konferencë për medie, trajneri Ilir Daja pret një ndeshje më të vështirë se ajo që u zhvillua një javë më parë në Turqi. "Presim të jetë një ndeshje ende më e vështirë sesa në Turqi. Ata vijnë nga një fitore si vendas në kampionat. Ata kërkojnë revanshin ndaj nesh. Neve na bën më të fortë për shkak se Sivasspori dhe ekipet e tjera në grup kanë më shumë përvojë. Duhet të luajmë më fort në fushën tonë. Nëse nuk luajmë në grup, kualitetet e Sivassporit mund të na dëmtojnë në çdo moment", ka thënë Daja, i cili ka konfirmuar se kapiteni Edvin Kuç do të mungojë edhe në këtë ndeshje. "Kapiteni Kuç nuk do të jetë i gatshëm, ka disa ditë që ka filluar vrapimet, por nuk ka bërë stërvitje me grupin. Ai do të jetë në bankinë, edhe pse nuk do të luajë 99 %." Rikthimi i Astrit Thaqit është një bonus për ne, por e kemi të dëmtuar edhe Veton Tushën.

Në konferencë për medie, krahas trajnerit Daja, ishte edhe mesfushori Qëndrim Zyba. Ky i fundit është optimist se skuadra e Ballkanit do t'i gëzojë të gjithë sportdashësit në Kosovë. "Na pret një ndeshje mjaft e vështirë, kundërshtari ka kualitet. Do

të jemi maksimalisht të përqendruar që t'i gëzojmë të gjithë sportdashësit kosovarë dhe shqiptarë, por e dimë që na pret një ndeshje mjaft e vështirë. Trajneri na shton besimin kur na jep detyra që t'i sulmojmë skuadrat. Kemi më shumë freski në ndeshje, na ndihmon shumë trajneri në vetëbesim dhe çdo gjë tjetër", ka thënë Zyba. "Do të kemi përkrahje të madhe nga të gjithë. Një gjë e tillë na motivon më

Presidentja Osmani i motivon futbollistët e Ballkanit para ndeshjes me Sivassporin



shumë. Do të qëndrojmë me këmbë në tokë. Shpresoj t'i gëzojmë tifozët tanë. Unë shpresoj që të na nënvlerësojnë edhe në vazhdim, sepse një gjë e tillë është në të mirën tonë. Besoj se Sivasspori i ka marrë masat e duhura për takimin e nesërm pas fitores sonë në Turqi", ka përfunduar Zyba. FC Ballkani ka njoftuar të mërkurën se janë shitur të gjitha biletat për ndeshjen kundër Sivassporit. Kampioni i Kosovës momentalisht kryeson Grupin G, ndërkaq kanë mbetur gjithsej edhe tri ndeshje për t'u zhvilluar. Në ndeshjen e fundit kundër Sivassporit, Ballkani ka shënuar fitore me rezultat 3:4.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka organizuar pritje për skuadrën kampione të Kosovës në futboll, FC Ballkani. E para e vendit i ka uruar kampionët e Kosovës për suksesin e arritur në Ligën e Konferencës dhe me këtë rast u ka uruar suksese edhe në ndeshjen e radhës kundër Sivassporit, e cila zhvillohet sonte në stadiumin "Fadil Vokrri". "Djelmohat e FC 'Ballkani' nga Suhareka kanë shënuar sukses historik në garat evropiane të Ligës së Konferencës së UEFA-s. Sot pata kënaqësinë t'i pres në zyrën time, t'i përgëzoj për sukseset e deritashme dhe t'u uroj fitore në përballje me ekipin Sivasspor", ka thënë Osmani.

SHKURT

Muriqi mungon në dy ndeshje

Vedat Muriqi do të mungojë në dy ndeshjet e radhës të Mallorcas pas kartonit të kuq që mori në sfidën e fundjavës kundër Elches. Muriqi goditi kundërshtarin dhe, pas intervenimit të sistemit VAR, ai u ndëshkua me karton të kuq. Muriqi me këtë rast do t'i humbë dy ndeshjet e radhës të ekipit ishullor kundër Sevillës në "Son Moix" këtë të shtunë dhe kundër Real Sociedadit në Donosti të mërkurën tjetër. Kjo padyshim do të jetë një mungesë e madhe për Mallorcan duke e pasur parasysh se Muriqi është golashënuesi më i mirë i ekipit deri tash me 4 gola nga 8 ndeshje.

Celta Vigo interesohet për Dakun

Reprezentuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi, rezultoi profili i duhur për kampionatin spanjoll. Sulmuesi nga Prizreni po shkëlqen me gola për Mallorcan dhe kjo ka nxitur Celta Vigon të shohë për një profil të ngjashëm për repartin e sulmit. Kandidati kryesor është Mirlind Daku. I ngjashëm me Muriqin dhe me një nuhatje të mirë për golin, sulmuesi shqiptar ka joshur drejtuesit e klubit të La Ligas. Ish-lojtari i Kukësit dështoi të lë gjurmë në kampionatin shqiptar, shkëlqeu me gola me ekipin e Ballkanit, ndërsa të njëjtën gjë është duke e bërë edhe tani me fanellën e Muras në Slloveni. Mediet spanjolle raportojnë për një transferim të mundshëm të Dakut në një merkaton e janarit. Kartoni i sulmuesit vlerësohet me shifrën 800 mijë euro nga "Transfermarkt".

KB Bashkimi përforcohet me Dajuan Graf

KB Bashkimi është përforcuar me një tjetër basketbollist të huaj. Bëhet fjalë për Dajuan Graf i cili edhe më herët ka luajtur në Kosovë. Fundori amerikan ishte pjesë e Golden Eagle Yllit në sezonin e kaluar, skuadër me të cilën e fitoi titullin e kampionit. Graf me klubin prizrenas ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri në fund të këtij sezoni. Graf pritet të debutojë me Bashkimin në fundjavë në ndeshjen kundër Pejës.

Andrej Panadiq, trajner i Ferizajt

FC Ferizaj ka njoftuar se trajneri nga Kroacia, Andrej Panadiq, do ta drejtojë skuadrën. Ai si futbollist ka luajtur me klube të njohura si Dinamo Zagreb, Hamburg dhe Sturm Graz. Sa i përket karrierës së trajnerit ai ka drejtuar klube si Radnik, LASK Linz, Istra, Krski dhe Rudar Velenje. "Me këtë rast, presidenti i ekipit, Lulzim Abazi, është shprehur i kënaqur që është arritur marrëveshja me një trajner që është figurë e rëndësishme e futbollit evropian dhe se shpreson se përvoja e dijet e fituara do të shërbejnë për ngritjen e cilësisë të ekipit të FC Ferizaj", thuhet në njoftimin e klubit. Panadiq do ta zëvendësojë Abnor Morinën që dha dorëheqje para disa ditësh.

Legjenda e Unitedit: Broja përfitoi nga largimi i Tuchelit

LONDËR, 12 TETOR - Goli i shënuar kundër Wolvesit, i pari me fanellën e Chelseat, rrit ende më shumë kuotat e Armando Brojës në sytë e trajnerit Potter. Për fat të keq, trajneri i bluve nuk i rezervoi asnjë minutë në sfidën kundër

Milanit, pavarësisht se ishte me një lojtar më shumë pas minutës së 18. Ky detaj ka pak rëndësi për legjendën e Manchester Unitedit dhe përfaqësueses angleze, Rio Ferdinand, i cili beson se Broja do të ketë më shumë shanse

me Potterin në stol: "Chelsea ka shumë lojtarë të rinj. Një nga ata është Broja. Ai ka shumë klube që e vlerësojnë, por te Chelsea duket se kanë ndryshuar filozofi pasi në të kaluarën me siguri do ta kishin shitur. Kështu është edhe

situata me Gallagherin, por tashmë të rinjtë si Broja po vlerësohen dhe në klub janë të kënaqur nga zgjedhja për të mos i larguar. Kam përshtypjen që të rinjtë do të përfitojnë nga largimi i Tuchelit pasi Potteri u beson shumë lojtarëve të së



ardhmes. Chelsea ka një akademi fantastike".

Berisha: I kam kualitetet e duhura për të luajtur në Botëror me Gjermaninë

AUGSBURG, 12 TETOR - Mërgim Berisha ishte shpallur kampion i Evropës me ekipin U-21 të Gjermanisë, por futbollisti kosovar nuk është ftuar në moshat e tjera më të mëdha të këtij shteti. Sulmuesi nga Suhareka u rikthye në futbollin gjerman gjatë verës për t'u huazuar në Augsburg nga Fenerbahçe. Ditë më parë trajneri i tij i ri, Stefan Reuter, e kishte lidhur me një mundësi të pjesëmarrjes në Kampionat Botëror, duke e përfaqësuar ekipin senior të Gjermanisë. "Ka kualitete enorme në ekipin kombëtar, selektori ka shumë mundësi zgjedhjeje, posaçërisht në aspektin ofensiv. Por, nuk mund ta dini prej tash se cila do të jetë gjendja fizike e lojtarëve në muajin nëntor. Mërgimi është një lojtar mjaft i mirë, ekstremisht i rrezikshëm, i cili nga dita e parë ka treguar se mund të përballlet me



qendërmbrojtësit më të mirë", ka deklaruar trajneri i Augsburgut. E një dëshirë apo ëndërr të tillë e ka edhe vetë 24-vjeçari. "Jam mjaft i lumtur për këtë (fjalët e trajnerit) dhe mendoj se i kam kualitetet e duhura për të luajtur në Kombëtare. Me U-21 jemi shpallur

kampionë të Evropës në vitin 2021 dhe do ta bëj më të mirën për ta vazhduar këtë kapitull", ka thënë Berisha për "Sport Bild". Berishën që një kohë është duke e pritur Kombëtarja e Kosovës, por duket se ai është më shumë i vendosur të luajë për Gjermaninë.

SHKURT

Potter: Nuk është lehtë të fitosh në 'San Siro'

Trajneri Chelseat, Graham Potter, është shprehur i kënaqur me fitoren ndaj Milanit me rezultat 0-2 në "San Siro". "Të vish këtu dhe të fitosh nuk është e lehtë. Merita për lojtarët. Ata ishin vërtet të mirë. Ne patëm pak fat me kundërshtarët që mbetën 10 lojtarë. Është mirë për penalltinë dhe bukur për Jorginho të shënojë. Në përgjithësi performanca ishte e mirë", ka deklaruar Potteri. "Ju mund të shihni se djemtë kanë cilësi. Ata janë një grup i përgjegjshëm, janë të sinqertë dhe të hapur dhe mua më pëlqen shumë të punoj me ta", ka shtuar Potter.

Guardiola: E vështirë ta fitosh Ligën e Kampionëve, aty është gjithmonë Real

Pep Guardiola ka folur për synimet e tij për ta fituar Ligën e Kampionëve me Manchester Cityn. Trajneri spanjoll e pranon se kjo do të jetë mjaft e vështirë për t'u arritur pasi aty ka gjithmonë klube të mëdha konkurrenente, siç është Real Madridi. "Liga e Kampionëve është mjaft e vështirë për t'u fituar sepse Real Madridi është gjithmonë aty. Ajo që e kemi marrë ndaj Copenhagenit është një pikë e mirë sepse nuk është e lehtë të fitosh në fund në një ndeshje 10 kundër 11. Jam mjaft i kënaqur me prezantimin e skuadrës", ka thënë Guardiola. "Haaland? E ka mbyllur lojën kundër Southamptonin me një lodhje të madhe dhe në ditët e fundit s'e ka marrë ende veten. Sot ishte më mirë, por ta lëmë të pushojë dhe të mos rrezikojmë me të", ka shtuar Guardiola.

E ardhmja e Mbappes mund të jetë në Premierë Ligë

Kylian Mbappe lëshoi një "bombë" të vërtetë në merkato, duke u kërkuar drejtuesve të PSG-së të largohet në janar, vetëm disa muaj pas rinovimit të kontratës. Ëndrra e tij ka qenë të ishte pjesë e Realit të Madridit, por kontrata që ka firmosur nuk e lejon këtë gjë. Gjithsesi "bookmakers"-at e cilësojnë Realin si klubin favorit për të arritur te sulmuesi francez. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë klubi që mund të arrijë te Mbappe është Liverpooli, i cili edhe më parë ka shfaqur interes për të. Pas Liverpoolit, vijnë Chelsea dhe Manchester City, ndërsa në listë ndodhen edhe Bayern Munchen dhe Manchester Unitedi. Gjithsesi, ende nuk ka një ofertë drejt tij, edhe pse skuadrat më të mëdha të Evropës do të duan që të kenë në radhët e tyre një lojtar të madh si Mbappe.

Tonali akuzon gjyqtarët për humbjen e Milanit

Mesfushori i Milanit, Sandro Tonali, ka kritikuar gjyqtarin në ndeshjen kundër Chelseas e cila përfundoi me rezultatin 0-2. Ai ka thënë se gjyqtarët janë fajtorë për humbjen e skuadrës kuqezi. "Ne filluam një ndeshje të mirë me ndihmën e tifozëve tanë. Më pas ishte ai problem që u përballëm, atë që gjyqtari krijoi. Një penallti dhe një karton i kuq në Ligën e Kampionëve pas më pak se 20 minuta nuk do të ishte dhënë kurrë. Ndër të tjera, arbitrimi i tillë, me 7 faulle dhe 4 kartonë në pjesën e parë, ishte i ekzagjeruar. Na dërguan gjyqtarët në këtë rezultat. Në çdo rast ne luajtëm me zemër falë edhe tifozëve tanë", ka thënë Tonali.

Henry, Mbappes: Mendon se je më i rëndësishëm se PSG-ja?

PARIS, 12 TETOR - Kylian Mbappe zgjodhi në verë rinovimin dhe qëndrimin te PSG-ja përpara transferimit si lojtar i lirë te Realit të Madridit. Kampionët e Francës i dhuruan sulmuesit një kontratë faraonike dhe i plotësuan çdo dëshirë, por raporti mes tij dhe klubit është prishur. 23-vjeçari është mërziur në kryeqytetin francez dhe ka pakënaqësi rreth pozicionit në fushë, pasi nuk dëshiron të luajë në krah, ndërkohë që shumë po flitet për një largim të tij në merkaton e janarit.

Thierry Henry, ish-sulmuesi i madh francez, i cili aktualisht është pjesë e stafit teknik në kombëtaren e Belgjikës, ka komentuar situatën për "CBS Sports". "Ka diçka që vlen më shumë se çdo futbollist: ky është klubi. A e di Mbappe dhe a është i vetëdijshëm që PSG-ja është më i rëndësishëm se ai? A e di këtë Kylian apo mendon se është më i rëndësishëm se vetë klubi?", ka



thënë Henry. "Akoma nuk i di me saktësi shkaqet pse Mbappe është mërziur, por dua të flas në lidhje me diçka që më ka ndodhur edhe mua. Mua nuk më pëlqente të luaja në krah te Barcelona, e urreja një gjë të tillë, por gjithmonë zbrisja në fushë dhe luaja në krah për të mirën e skuadrës. Ekziston vetëm një rregull: nëse trajneri të

jep një urdhër, ti e zbaton atë për të mirën e të gjithëve. Nëse nuk je i sigurt për ta bërë, atëherë duhet të ulesh të bisedosh me trajnerin. Kaq e thjeshtë është", ka shtuar Henry, i cili në vitin 2007 u transferua nga Arsenali te Barcelona dhe fitoi Ligën e Kampionëve me ekipin katalanas dy vjet më vonë.

Verstappen: Sezonin e ardhshëm do të jetë shumë më vështirë ta fitojmë titullin

Max Verstappeni u konfirmua kampion bote në Formula 1, një titull që këtë vit ishte më i lehtë për t'u arritur krahasuar me atë të një viti më parë. Gjithsesi, piloti

holandez i Red Bullit shprehet se sezonin e ardhshëm ka për të qenë shumë më e vështirë për të arritur te titulli. "Gara e fundit në Japoni ishte e çuditshme, pasi kur kalova

vijën e finishit nuk e dija nëse isha kampion apo jo. Gjithsesi, duke reflektuar gjithçka ndodhi këtë sezon, mendoj se ishim më mirë se rivalët tanë. Kemi kaluar shumë momente të bukura

dhe titulli ishte i merituar", ka thënë Verstappen. "Për këtë arsye është më mirë ta shijojmë momentin, pasi sezonin e ardhshëm do të jetë shumë e vështirë ta fitojmë titullin. Ferrari nuk

do t'i përsëritë më të njëjtat gabime, ndërkohë që do ta kemi rival edhe Mercedesin. Ndaj duhet shumë më tepër punë për t'u rikonfirmuar kampionë", ka shtuar Verstappen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Ndërmarrja e Re IBG Industria e Bativerive Gjilan” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810813156 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit Shaban Ismajli Prishtinw nr tel: 044-194-334. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ndërmarrja e re IBG Industria e Bativerive Gjilan” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810813156 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije Shaban Ismajli Pristine nr tel: 044-194-334. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Ndërmarrja e re IBG Industria e Bativerive Gjilan” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810813156 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process, Shaban Ismajli Prishtinw nr tel: 044-194-334. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erion Cocaj shpall të pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.
- Granit Curri shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore.
- Leotrim Berisha, shpall të pavlefshme INDEX-in, e lëshuar nga Kolegji "Dardania" me nr. MA-2,013-11, drejtimi Administratë Publike.
- Dibran Bytyci shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- Denis Hoxha shpall të pavlefshme dëftesën e kl X shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- Rasim Halitjaha shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Mati Logoreci " Prizren.
- Besim B Hajdini B.I. Llabjan Novobërdë, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330435182.
- Kaltrina Kaquri nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës X dhe XI të shkollës "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoh një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ROYAL CROWN,
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales